



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADÄ KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date:
Prishtinë / a	

Nr. 58/2020  
Datë: 19.06.2020

Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë, bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Udhëzimin Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, në takimin e mbajtur me datë 18.06.2020, mori:

**V E N D I M**


- I. Pezullohen të gjitha aktivitetet, përfshirë edhe afatet ligjore të parapara me UA për 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, lidhur me përcaktimin e çmimeve të barnave, deri në një vendim tjetër.
- II. Të adresohet kërkesa për opinion ligjor nga MPB (MAP), në cilësinë e sponsorizuesit të Ligjit për Procedurën Administrative, lidhur me të drejtën e Komisionit të Ankesave për kthim të lëndëve në ryshqyrtim.
- III. Të adresohet kërkesa për opinion ligjor nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur me zbatueshmërinë e UA për 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, bazuar në pretendimet e Komisionit të Ankesave.
- IV. Të shqyrtohet mundësia e marrjes së listave zyrtare të çmimeve të barnave nga Turqia dhe Shqipëria.
- V. Obligohet sekretaria e komisionit, respektivisht Divizioni i Farmacisë për zbatimin e vendimit.

**A r s y e t i m i**

Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, me qëllim të sqarimeve të dyshimeve të ngritura nga Komisioni i Ankesave, mbi ligjshmërinë e procesit të përcaktimit të çmimeve të barnave, respektivisht zbatueshmërinë e UA për 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Dr. Naim Bardiqi

Kryesues i Komisionit



Vendim i dërgohet:

1. Kabinetit të Ministririt;
2. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Akterëve të involvuar në proces;
4. Arkivës së MSh-së